

VENDIM

Nr. 221, date 16.5.2002

PER DISA SHITESADHE NDRYSHIME NE VENDIMIN NR. 231, DATE 11.5.2000 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER PRANIMIN NE SHERBIMIN CIVIL DHE PERIUDHEN E PROVES", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.196, DATE 6.4.2001 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te nenit 29 te ligjit nr.8549, date 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Ne vendimin nr. 231, date 11.5.2000 te Këshillit te Ministrave "Për pranimin ne shërbimin civil dhe periudhën e provës" , ndryshuar me vendimin nr .196, date 6.4 .2001 te Këshillit te Ministrave bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Shkronja "b" e pikës 11 ndryshon si me poshtë vijon:

"b) Dy pedagoge nga fakulteti, sipas fushës ku do te zhvillohet testimi, te përcaktuar nga dekanati përkatës apo dy specialiste te njohur ne fushën përkatëse, te përcaktuar nga fakultetet apo institucionet e tjera, arsimore-shkencore, sipas kërkesës dhe kriterëve te Departamentit te Administratës Publike për institucionet qendrore dhe te departamentit, drejtorisë, seksionit apo zyrës se personelit për institucionet e pavarura. " .

2. Pika 14 ndryshon si me poshtë vijon:

" 14. Personat e përcaktuar ne shkronjën "b" te pikës 11 te këtij vendimi shpërblehen ne masën 6 500 (gjashte mije e pesëqind) leke për çdo dite angazhimi ne testime. Te gjitha shpenzimet përballohen nga buxheti i institucionit për te cilin zhvillohet konkurrimi. " .

3. Pika 18 ndryshon si me poshtë vijon:

" 18. Menjëherë pas nxjerrjes se rezultateve nga komiteti ad-hoc, kryetari shpall listën me renditjen e kandidateve dhe shumën e pikëve te testimit për çdo kandidat, ne një vend te dukshëm, te caktuar, ne ndërtesën ku është zhvilluar testimi dhe ne buletin e Departamentit te Administratës Publike. " .

4. Pika 19 ndryshon si me poshtë vijon:

"19. Eprorit direkt i paraqiten tre kandidatet me rezultatet me te mira nga Departamenti i Administratës Publike për institucionet e administratës qendrore dhe nga departamenti, drejtoria, seksioni apo zyrat e personelit për institucionet e pavarura. Eprori direkt zgjedh njërin prej tyre pas një bashkëbisedimi me secilin nga te tre kandidatet e propozuar. Eprori direkt mund te kërkojë përsëritjen e procedurës se pranimit kur asnjeri nga kandidatet nuk ka marre mbi 50 pike. Ne çdo rast, vendimi i eprorit direkt duhet te jete i motivuar dhe i bazuar ne parimet e barazisë, mirëbesimit dhe mosdiskriminimit. Vendimi i eprorit direkt jepet pas verifikimit te vërtetësisë se dokumenteve, ne mbështetje te te cilave është kryer procesi i konkurrimet. " .

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko